



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVA
REPUBLIKA KOSOVA

KOMUNA E DEÇANIT
MUNICIPALITY OF DEÇAN
OPSTINA DEÇAN



Drejtoria për Gjeodezi dhe Kadastër
12- Zyrtarisht /2022
Deçan, 12.07.2022

Për: Kryetarin e Komunës së Deçanit
Z. Bashkim Ramosaj

Përmes: Drejtorit të Drejtorisë Z. Agron Muslijaj _____

Nga : Shefi i Drejtorisë Z. Hasan Hulaj _____

Lënda: Raport Pune për periudhën 04 Janar – 01 Korrik 2021, i Drejtorisë për
Gjeodezi dhe Kadastër në Komunën e Deçanit

Së bashku me këtë shkresë do gjeni edhe Raportin e punës për periudhe 04 Janar – 01 Korrik 2021 për
Drejtorinë e Gjeodezisë dhe Kadastrit në Deçan

R A P O R T P U N E

Për periudhën 01Janar 2022– 01Korrik2022 i Drejtorisë për Gjeodezi dhe Kadastër në Deçan

1. Shefi i Sherbimit njëkohësisht edhe zyrtari për RDPP së bashku me referenten e ndryshimeve kadastrale

Gjatë periudhës për të cilën po raportojmë përkatësisht prej fillimit të vitit 2022 e deri me datën e përpilimit të këtij raporti , Zyrtari për RDPP ka pranuar gjithsejtë **326** kërkesa nga palë të ndryshme për realizimin e të drejtave ligjore që dalin nga Regjistrimi i të Drejtave në Pronën e Paluajtshme (RDPP).

Nga të gjitha këto kërkesa deri më tani janë shqyrtuar **305** dhe për të njëjtat janë lëshuar aktvendime adekuate me të cilat palëve iu është njohtë e drejta ligjore e kërkuar ose ju ka refuzuar e njëjta kërkesë dhe ju ka dhënë e drejta e ankesës në organin e shkallës së dytë. Ndërsa **21**kërkesa janë në procedurë e sipër.

I njëjti ka lëshuar 166 aktvendime për azhurim të lëndëve të terrenit.

Aktvendimet me të cilat palës i është njohur e drejta në RDPP, në afat ligjor dërgohen te referentja për ndryshime kadastrale e cila konform këtyre vendimeve bënë azhurimin në librat përkatës të elaboratit kadastral dhe të njëjtat prapë i azhurnon duke i fut të dhënat në kompjuter përkatësisht në programin e SIKTK-es.

Krahas këtyre punëve Zyrtari për RDPP i cili i kryen edhe detyrat e shefit të shërbimit ka kryer edhe punë tjera nga lëmi i shërbimeve pronëso- juridike dhe së bashku me referenten për ndryshime kadastrale kanë kryer edhe punë tjera me urdhër të drejtorit .

2. Zyrtarët e mirëmbajtjes së Kadastrit

Në këtë sektor punojnë tre zyrtarë për mirëmbajtjen e Kadastrit .

Këta zyrtarë gjatë periudhës raportuese i kanë pasur **160**azhurime të lëndëve nga tereni sipas kërkesës së palëvesiq janë : ndarja e parcelave, bashkimi i parcelave, regjistrimi i objekteve, korrjigjimi i sipërfaqeve, korrjigjimi i mexhave dhe futja e të dhënave të reja në sistem etj.Këto lëndë të gjitha janë zgjedhur me përjashtim të **6** rasteve të cilat ende janë në procedurë e sipër.

Gjithashtu këta zyrtarë gjatë kësaj periudhe kanë lëshuar **8** historiate dhe identifikime të mexhave sipas kërkesave të palëve dhe kanë lëshuar **250**kopje plani.

Gjatë kësaj periudhe raportuese këta zyrtar kanë dal në teren për **4** raste nga domeni pronëso-ro-juridike sipas kërkesës zyrtare të bërë nga ana e Komunës së Deçanit, për nevoja të Komunës. Si dhe kanë kryer edhe detyra tjera sipas nevojave të cilat paraqiten në këtë shërbim siç janë konsultat me palë dhe punë tjera në zyrë.

3. Referenti për pranimin e palëve

Gjatë periudhës për të cilën raportojmë, referenti për pranimin e palëve ka pranuar gjithsejtë **1287** kërkesa të cilat kryesisht kanë të bëjnë me dhënien e certifikatave të pronës së paluajtshme, kopjeve të planit dhe vërtetimeve me të cilat vërtetohet se a ka apo nuk ka pala pasuri të paluajtshme, në territorin e Komunës.

I njëjti zyrtar i ka proceduar të gjitha këto kërkesa dhe për secilën kërkesë palët janë pajisur me dokumente përkatëse në afatin brenda ditës së paraqitjes së kërkesës. I njëjti punëtor krahas këtyre punëve ka kryer edhe punët e përpunuesit në SIKTK.

Për hir të thjeshtësimit të të dhënave për punët e kryera të këtyre punëtorëve, këtij raporti po ia bashkëngjitem edhe formën tabelare të lëndëve të pranuar sipas muajve dhe llojit të kërkesave .

| Lloji i lëndëve | Janar | Shkurt | Mars | Prill | Maj | Qershor | Totali |
|--|--------------|---------------|-------------|--------------|------------|----------------|---------------|
| <i>Aktvendimet për ndryshime kadastrale</i> | 056 | 041 | 070 | 060 | 045 | 054 | 326 |
| <i>Azhurimi i lëndëve -Tereni</i> | 026 | 014 | 024 | 029 | 039 | 035 | 167 |
| <i>Lëshuarja e certifikatave</i> | 214 | 200 | 228 | 224 | 210 | 211 | 1287 |
| <i>Totali për Muaj</i> | 296 | 255 | 322 | 313 | 294 | 300 | 1780 |

Kjo Drejtori krahas këtyre punëve të evidentuara më lartë ka kryer edhe punë tjera të parashtruara konform kërkesave të palëve private dhe organeve komunale.

Raportin e përpiloi :
Shefi i kësaj Drejtorie
Hasan Hulaj

D r e j t o r i
Agron Muslijaj
